

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi pritet në orën 10:00: Kosova, diaspora dhe Haga në pritje të aktgjykimit
ADRESA	https://albeu.com/kosove/vendimi-pritet-ne-oren-1000-kosova-diaspora-dhe-haga-ne-pritje-te-aktgjykimit/1013512/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 05:30:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 05:25:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0710b8ef6243f2a5d72fa8e836e1f1d536b11b182dccc10c4e5afda0b3308726
TEKSTI	7e13283184f5e93bb423cf2b572e2c474ee8e8cb1e433346f8b8164d060e63b9
PAMJA	682efd14111f0cbc50e8a4be5a4fa0a992deea94be2ff95a1799ce1bee96d9b2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c0eb0cfc6b7a8b40f8605db36122b5f3c6043d802f214bc5b1a6620b0ece1f14
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6d9560e9dee7d667e4c0855efa59278dec1e8935faed252449ae9de5f9970896
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c0eb0cfc6b7a8b40f8605db36122b5f3c6043d802f214bc5b1a6620b0ece1f14>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Vendimi pritet në orën 10:00: Kosova, diaspora dhe Haga në pritje të aktgjykimit



Vetëm pak orë kanë mbetur deri te një prej vendimeve më të rëndësishme dhe më të ndjeshme gjyqësore për Kosovën në periudhën e pasluftës.

Të mërkurën, më 16 shtator, duke nisur nga ora 10:00, Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë do të shpallin aktgjykimin e shkallës së parë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Seanca do të zhvillohet në publik dhe do të ndiqet drejtpërdrejt përmes faqes zyrtare të Dhomave të Specializuara, në gjuhët shqipe, angleze dhe serbe. Sipas njoftimeve të bëra para seancës, shpallja e aktgjykimit pritët të zgjasë rreth dy orë, deri afërsisht në mesditë.

Kjo kohëzgjatje nuk nënkupton se gjykata do të lexojë të gjithë dokumentin e aktgjykimit. Në raste të tilla, kryetari i Trupit Gjyqësor zakonisht përmbledh konstatimet kryesore dhe më pas njofton vendimin për çdo pikë të aktakuzës dhe për secilin të akuzuar.

Vendimi i së mërkurës do të jetë i shkallës së parë dhe, cilido qoftë përfundimi, palët do të mund të paraqesin ankesë.

Mbështetësit mbledhen në Hagë

Gjatë së martës, në Hagë kanë mbërritur qytetarë nga Kosova dhe nga vende të ndryshme evropiane. Në pamjet e publikuara nga zona pranë gjykatës janë parë flamuj shqiptarë, flamuj të Kosovës dhe simbole të UÇK-së.

Disa pjesëmarrës kanë deklaruar se do ta presin vendimin gjatë natës pranë ndërtesës së Gjykatës, edhe në qiej të hapur. Organizatat e dala nga lufta kanë njoftuar se në Hagë pritët të mbledhen qytetarë nga Kosova dhe diaspora.

Forcat e policisë holandeze kanë shtuar masat e sigurisë në rrethinë dhe u kanë bërë thirrje të pranishmëve të

të fundit /



Vendimi pritët në orën 10:00: Kosova, diaspora dhe Haga n...



Helikopteri përplasët pranë zonës tregtare në Los Angeles, tre viktima



Parashikimi i motit 16 Shtator 2026/ Kthjellime dhe vranësira, reshje...



Barcelona hap negociatat për rinovimin e Raphinha, Deco...



Pse disa njerëz nuk e ndryshojnë fotografinë e profilit për vite me...



Horoskopi 16 Shtator 2026/ Njihuni me surprizat e yjeve për...



Dëmtimet më të zakonshme nga aksidentet me skuter...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

... dhe e përshkruan në mënyrë të saktë dhe e organizon në mënyrë të mirë dhe e krahon me të gjitha të pranishmit të të qendrojnë në hapësirat e përcaktuara. Deri në mbrëmje, nuk janë shënuar incidente serioze.

Prishtina e pret vendimin me “Natën e Pritjes”

Edhe në Prishtinë janë zhvilluar përgatitje për ndjekjen e aktgjykimit. Në kryeqytet është ndezur “Flaka e Lirisë”, ndërsa qytetarë janë mbledhur para ekranit të madh ku janë vendosur portretet e Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit.

Pjesëmarrësit kanë thënë se synojnë të qëndrojnë në shesh përgjatë gjithë natës. Nga i njëjti vend pritet të ndiqet bashkërisht transmetimi i seancës nga Haga.

Veprimtari në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së janë zhvilluar ose janë lajmëruar edhe në Skenderaj, Mitrovicë dhe qytete të tjera. Në Shkup është mbajtur një marsh, ndërsa mbështetje kanë shprehur edhe përfaqësues politikë në Shqipëri dhe organizata të diasporës.

Në Hagë shkojnë familjarë dhe figura politike

Mes personave që kanë udhëtuar drejt Hagës janë edhe familjarë të të akuzuarve. Ish-deputeti Abelard Tahiri publikoi pamje nga udhëtimi i tij së bashku me Endrit Thaçin, djalin e Hashim Thaçit.

Vlora Çitaku, Sekretare e Përgjithshme e PDK-së, njoftoi nga Haga se ndodhet atje për të pritur vendimin. Është bërë e ditur gjithashtu se pritet të jetë i pranishëm Glauk Konjufca. Në drejtim të Hagës kanë marrë rrugë edhe përfaqësues të organizatave të luftës, ish-luftëtarë, aktivistë dhe pjesëtarë të diasporës.

Gjykata nuk ka publikuar listën përfundimtare të familjarëve dhe personaliteteve që do të lejohen në sallë. Vendet në galerinë e saj janë të kufizuara, ndërsa hyrja mundësohet vetëm për personat e regjistruar paraprakisht dhe të pajisur me konfirmim zyrtar.

Akuzat që shqyrtohen nga Gjykata

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi akuzohen për gjashtë vepra të krimeve kundër njerëzimit dhe katër vepra të krimeve të luftës. Në aktakuzë përfshihen, ndër të tjera, përndjekja, burgosja, tortura, vrasja e paligjshme dhe zhdukja me forcë.

Prokuroria pretendon se këto vepra janë kryer në disa lokacione në Kosovë dhe në veri të Shqipërisë, në periudhën nga marsi i vitit 1998 deri në shtator të vitit 1999.

Të gjithë të akuzuarit i kanë hedhur poshtë pretendimet e Prokurorisë dhe janë deklaruar të pafajshëm.

Procesi gjyqësor nisi më 3 prill 2023. Në gjykim dëshmuan 134 persona, prej të cilëve 125 u thirrën nga Prokuroria, dy nga mbrojtësi i viktimit dhe shtatë nga ekipet mbrojtëse. Në procedurë u përfshinë 156 viktima të pranuar nga Gjykata. Provat përfunduan së paraqituri në dhjetor të vitit 2025, ndërsa deklaratat përmbyllëse u dhanë në shkurt të vitit 2026.

Pritja për orën vendimtare

Familjarët dhe mbështetësit shpresojnë që vendimi të jetë lirues, por përfundimi i çështjes do të bëhet i ditur vetëm kur Trupi Gjykues ta shpallë zyrtarisht aktgjykimin.

Ndërkohë, orët para seancës po shoqërohen me pritje, pasiguri dhe mobilizim qytetar. Në Hagë, Prishtinë, trojet shqiptare dhe në diasporë, vëmendja është përqendruar te ora 10:00 e 16 shtatorit.

Shtuar më 16.09.2026 07:25

Tags: 134 dëshmitarë , gjithçka , kosova ,
mergata , sytë nga Haga



Vendimi i Hagës në orën 10:00, Kosova dhe diaspora presin aktgjykim...



Qytetarët largohen nga zona pranë Gjykatës në Hagë, nesër shpallet...



Ekipet malore nisin operacion shpëtimi në Bjeshkët e Nemuna, në...



Në prag të vendimit, qindra shqiptarë mbledhen pranë Gjykatës Speciale në Hagë





Berisha: Ish-udhëheqësit e UÇK-së meritojnë vetëm pafajësinë



Kurti takon liderët shqiptarë të Luginës dhe rithekson mbështetjen e Kosovës



NATO rikonfirmon përkushtimin e palëkundur ndaj sigurisë së Kosovës



Koncentrati serb "SELECT MILK GR" tërhiqet nga tregu me urdhër të AUV-s...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com |

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.